LIGJ
Nr.7600, datë 8.9.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7499, DATË 6.7.1991 "PËR RIVENDOSJEN E GRADAVE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7499, datë 6.7.1991, neni 10 ndryshohet si vijon:

"Grada e parë për oficerët sapotitulluar të dalë nga shkollat ushtarake është nëntoger. Përjashtim bëhet për ata që mbarojnë shkollën me rezultate të shkëlqyera, grada e të cilëve është një shkallë më e lartë se grada e parë".

Për specialistët që merren nga jeta civile, grada jepet sipas funksionit organik përkatës të emërimit në momentin e titullimit të tyre si oficer".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.300, datë 21.9.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.